

## Fletë udhëzuese

Sipas nenit 36, par. 1, shkronja b të Konventës së Vjenës mbi Marrëdhëniet Konsullore, Republika Federale e Gjermanisë është e detyruar, që me kërkesën Tuaj, ta njoftojë menjëherë dhe pa humbur kohë përfaqësinë konsullore të vendit Tuaj mbi arrestim Tuaj. Njoftimi bëhet nga ana e gjyqit, prokurorisë ose nga ana e burgut.

**Përveç kësaj**, përfaqësisë së vendit Tuaj, **në qoftë se Ju jeni dakord me këtë**, mund t'i kumtohet edhe shkaku, në bazë të cilit jeni arrestuar. Ky pëlqim edhe mund të tërhiqet nga Juaj në çdo kohë.

Përveç kësaj, viheni në dijeni se janë bërë kontrata në mes të Republikës Federale të Gjermanisë dhe shteteve të ndryshme, të cilat parashikojnë detyrimisht lajmërimin e përfaqësisë Suaj konsullore mbi arrestimin Tuaj, edhe nëse nuk do të dëshironit një gjë të tillë apo edhe nëse do të kundërshtonit një gjë të tillë. Të tilla kontrata për momentin egzistojnë me këto shtete:

**Dominika, Fixhi, Grenada, Greqia, Gujana, Italia, Xhamajka, Lesoti, Malavia, Malta, Mauritania, Monakoja, Sierra Leone, Spanja\*, Shën Kitts dhe Nevis, Shën Vincenti dhe Grenadija, Tunezia, Mbretëria e Bashkuar e Britanisë së Madhe dhe Irlanda Veriore (duke përfshirë edhe Ishujt e Kanalit dhe Isle of Man si dhe kolonitë britanike të (Anguilës, Bermuda, Ishujt Britanike të Virgjëra, Ishujt Falkland, Gjibraltari, Ishujt e Kajmanit, Montserati, Pitkairni, Shën Helena, Ascension dhe Tristan da Cunha, Ishujt Turks dhe Kajkos)), Qiproja.**

Në qoftë se jeni shtetas i njërit nga këto shtete, atëherë nga ana e gjyqit, prokurorisë apo nga ana e burgut do të bëhet gjithsesi lajmërimi i përfaqësisë Suaj konsullore mbi arrestimit Tuaj, edhe nëse nuk do të dëshironit të bëhet një gjë e tillë.

Natyrisht se do të keni mundësinë ta bëni edhe vetë lajmërimin pranë përfaqësisë Suaj konsullore mbi arrestimin Tuaj dhe keni të drejtën t'i dërgoni asaj në çdo kohë njoftime.

\* Ju lutemi, vini re se një njoftim në rrugë zyrtare duhet të kryhet vetëm nëse ju nuk jeni në gjendje të kërkonti vetë njoftimin tek pika më e afërt konsullore në vendin tuaj të origjinës.